

**V E N D I M**  
**Nr.528, datë 13.5.1996**

**PËR MASAT PËR ZBATIMIN FIZIK TË KOMPENSIMIT ME TROJE NË ZONAT**  
**TURISTIKE, NË ZBATIM TË LIGJIT NR.8084, DATË 7.3.1996**

Në zbatim të ligjit nr.8084, datë 7.3.1996, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Të kompensojë fizikisht me troje në zonat turistike ish-pronarët (ose trashëgimtarët e tyre) të trojeve të zëna, që ndodhen brenda vijave kufizuese të qendrave të banuara, dhe ish-pronarët (ose trashëgimtarët e tyre) të tokave bujqësore ose jobujqësore, të cilat ndodhen jashtë vijave kufizuese të qendrave të banuara.

2. Kompensimi me troje në zonat turistike do të realizohet në 2 (dy) faza:

- Në fazën e parë kompensimi me troje do të jetë i plotë, por jo më shumë se 5000 m<sup>2</sup>.

a) Në këtë fazë përjashtohen nga kompensimi me troje në zonën turistike:

- Ish-pronarët (ose trashëgimtarët e tyre) që kanë marrë 5000 m<sup>2</sup> dhe më shumë truall nga zbatimi i ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

- Ish-pronarët e tokës bujqësore (ose trashëgimtarët e tyre) që nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" kanë marrë 5000 m<sup>2</sup> dhe më shumë si individë.

Për trashëgimtarët e tyre sasia e tokës që kanë përfutur, do t'i zbritet në përlllogaritjen e sipërfaqes së tokës që do t'u kompensohet në pjesën që i takon.

- Ish-pronarët (ose trashëgimtarët e tyre) e tokave bujqësore që nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" ose aktet e tjera nënligjore për shpërndarjen e pasurisë së ish-kooperativave bujqësore ose ndërmarrjeve bujqësore dhe çdo ligj tjetër që ka dalë për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, të cilët kanë marrë 5 000 m<sup>2</sup> sipërfaqe toke dhe më shumë. Këtu përfshihen edhe ata ish-pronarë ose trashëgimtarë ligjorë që kanë refuzuar marrjen e tokës bujqësore nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", kur sipërfaqja e pranuar së bashku me atë të refuzuar është 5000 m<sup>2</sup> për frymë.

- Ish-pronarët (ose trashëgimtarët e tyre) që u kanë kthyer ose kompensuar në natyrë 5000 m<sup>2</sup> dhe më shumë pyll, livadh apo tokë pyjore sipas zbatimit të ligjeve përkatëse.

3. Kompensimi me troje në zonat turistike do të bëhet mbi bazën e konvertimit që del nga formula:

Sip. x C1

Sk= -----

C2

a) Sk - Sipërfaqja që do të jepet në kompensim

b) Sip.- Sipërfaqja ish-pronë

c) C1- Sipas rastit

- Çmimi i truallit (në bazë të ligjit nr.7832, datë 16.6.1994 "Për çmimin e truallit që kompensohet").

- Çmimi i tokës bujqësore (në bazë të ligjit nr.7836, datë 22.6.1994 "Për çmimin e tokës bujqësore për efekt kompensimi").

- Çmimi i kullotave, livadheve dhe pyjeve për efekt kompensimi (sipas ligjit përkatës).

d) C2 - Çmimi për njësi i truallit që jepet për kompensim në zonat turistike (ligji nr.7832, datë 16.6.1994).

- Gjithashtu, llogaritja e konvertimit të tokave bujqësore, jobujqësore dhe e trojeve të zëna për kompensim me troje në zonat turistike dhe qendrat e banuara bëhet në bazë të tabelave që i bashkëngjiten këtij vendimi.

Sk= Sip. x k

k - koeficienti i konvertimit

Në rastet kur çmimi i tokës që kompensohet është i barabartë ose më i lartë se çmimi i truallit

që jepet për kompensim, kompensimi bëhet në truall aq sa është pretendimi, por jo më shumë se 5000 m<sup>2</sup> për fazën e parë sipas pikës 2 të këtij vendimi.

4. Kompensimi i ish-pronarëve (ose trashëgimtarëve të tyre) me troje në zonat turistike, bëhet mbi bazë të studimeve urbanistike të posaçme, të cilat miratohen nga KRRT e Shqipërisë.

Me “studime urbanistike të posaçme” do të kuptohen studimet urbanistike të cilat kryhen në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.468, datë 17.8.1995.

Numri i parceleve njësi që përfitohen do të jetë jo më i madh se numri i plotë i plotëpjesëtimit të sipërfaqes së tokës së konvertuar që do të kompensohet, me sipërfaqen e parcelës njësi që jepet për kompensim. Për diferencën e sipërfaqes së konvertuar që mbetet, ose për sipërfaqe të konvertuar nën sipërfaqen e parcelës njësi, ish-pronarëve u lind e drejta që në mirëkuptim midis tyre të marrin një ose më shumë parcela njësi në bashkëpronësi. Me dëshirë të ish-pronarit, diferenca e sipërfaqes së konvertuar që mbetet, kompensohet në vlerë.

Sipërfaqja e parcelës njësi që jepet për kompensim në zonën e zhvillimit të turizmit të nivelit ltuks dhe të lartë është 350 m<sup>2</sup>.

Sipërfaqja e parcelës njësi që jepet për kompensim në zonën e zhvillimit të turizmit të nivelit të mesëm është 500 m<sup>2</sup>.

5. Në radhën e kompensimit të ish-pronarëve do të respektohen përparësitë si më poshtë:

1. Ish-pronarët që kanë pasur tokë më afër tokës që përdoret për kompensim.

2. Ish-pronarët që kanë pasur tokë më afër llojit sipas zërit kadastral të tokës që do të përdoret për kompensim.

3. Banorët më të afërt të sipërfaqes që do të përdoret për kompensim.

4. Ish-pronarët që kanë pasur në dispozicion më shumë se 50 ha tokë, duke filluar nga pronësia me sipërfaqe më të madhe.

6. Studimet urbanistike të posaçme ndahen në zonë A dhe zonë B. Kjo ndarje miratohet nga KRRT e rrethit përkatës. Kriteri do të jetë largësia nga vija kufitare e brezit të rërës në drejtim të kundërt me brigjet ujore, në bregdet dhe liqene, dhe largësia nga rrugët kryesore të komunikimit në brendësi të vendit.

Trojet që shtrihen deri në 200 m thellësi nga vija kufitare, ku mbaron brezi i rërës, përbëjnë zonën A, kurse trojet që shtrihen përtej kësaj distance përbëjnë zonën B, sipas përcaktimit të bërë në paragrafin e parë të nenit 10 të ligjit nr.7832, datë 16.6.1994 “Për çmimin e truallit që kompensohet”.

Për truallin që ndodhet në zonën A, do të zbatohet çmimi i truallit të zonës sipas nenit 9 të ligjit nr.7832 “Për çmimin e truallit që kompensohet”.

Çmimi bazë për truallin që ndodhet në zonën e zhvillimit të turizmit të nivelit luks, është 3200 lekë/m<sup>2</sup>.

Për truallin që ndodhet në zonën e zhvillimit të turizmit të nivelit të lartë, çmimi bazë do të shumëzohet me koeficientin 0.5.

Për truallin që ndodhet në zonën e zhvillimit të turizmit të nivelit të mesëm, çmimi bazë do të shumëzohet me koeficientin 0.25.

Për truallin që ndodhet në zonën B, çmimi i truallit do të dalë nga shumëzimi me koeficientin 0.75 i çmimit të truallit të zonës.

Për qendrat e banuara, të cilat janë të zhvilluara pranë brigjeve ujore, ndarja në zonë A dhe B do të përcaktohet si më poshtë:

A- qendra dhe zona pranë brigjeve ujore.

B- pjesa që mbetet.

Ndarja e zonave do të miratohen nga KRRT e rretheve.

7. Në rastet kur sipërfaqja e dhënë për kompensim si truall është sipërfaqe pyjore dhe ka material drusor, çmimit bazë të zonës i shtohet tarifa faktike. Drejtoria e shërbimit pyjor të rrethit, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.82, datë 26.2.1993 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve”, sipas pikës 1 dhe 2 (në pasqyrën nr.1 do të merret në konsideratë vetëm pika 1) do të përcaktojë tarifën faktike shtesë.

8. Pranë Këshillit të Ministrave caktohet i ngarkuari për ndjekjen e kompensimit fizik të pronave ish-pronarëve.

9. Me vendim të këshillave të rretheve krijohen komisionet e kompensimit fizik në të gjitha rrethet e vendit, ku ndodhet toka që jepet për kompensim në zonë turistike.

a) Ky komision përbëhet nga:

Kryetar Komisioni .....I ngarkuari i prefektit për rrethin përkatës

Nënkryetar .....Jurist ose specialist nga seksioni i urbanistikës së rrethit  
(Urbanist ose arkitekt,  
ose topogjeodet, ose  
inxhinier ndërtimi)

Specialist .....Specialist nga seksioni i urbanistikës së rrethit  
(Urbanist ose arkitekt,  
ose topogjeodet, ose  
inxhinier ndërtimi)

Specialist .....Punonjës i kadastrës së rrethit ose i drejtorisë së shërbimit pyjor

Specialist .....Ekonomist

b) Financimi i Komisioneve të Kompensimit Fizik bëhet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

d) Kryetari i këtij komisioni:

- Raporton dhe përgjigjet drejtpërsëdrejti para kryetarit të Komisionit Shtetëror të Kompensimit Fizik dhe koordinon punën për realizimin e kompensimit fizik me këshillin e rrethit.

- Organizon dhe kontrollon punën e komisionit në evidencimin dhe realizimin e kompensimit fizik, si dhe për respektimin e afateve të realizimit të tij. Është përgjegjës për lajmërimet që do të kryhen në mjetet e informacionit (televizion). Është përgjegjës dhe mban përgjegjësi për organizimin e llotarisë së shpërndarjes së trojeve për kompensim.

e) Komisionet kanë këto detyra dhe të drejta themelore:

- Bëjnë shqyrtimin dhe klasifikimin e tokave bujqësore, jobujqësore dhe të trojeve që kompensohen sipas prioritetëve (neni 5 i ligjit nr.8084, datë 7.3.1996), bën konvertimin e tyre me troje në zonë turistike dhe qendra të banuara, si dhe organizon e ndjek realizimin e llotarisë për përcaktimin e kompensimit fizik.

- Kur dyshojnë në dokumentacionin e sjellë nga ish-pronarët, kanë të drejtë të bëjnë verifikimin me kopjet e ndodhura në dosjet e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve të rrethit apo të bashkisë.

- Kërkon nga seksioni i urbanistikës në rreth të vërë në dispozicion të tij tri kopje të studimit urbanistik të miratuar për kompensimin fizik, ku të jenë të përcaktuara ndarja e zonave në zbatim të ligjit nr.7832, datë 16.6.1994 (njëra për afishim dhe dy të tjerat për pasqyrimin e rezultateve të llotarisë).

- Kërkon nga seksioni i urbanistikës në rreth dhe bashki dokumentet grafike, në të cilat përcaktohet vija kufizuese mbrojtëse e zonës me interes zhvillimin e turizmit, ku bëhet kompensimi fizik.

- Komisionet e kompensimit fizik të rretheve mbulojnë veprimtarinë e kompensimit fizik të ish-pronarëve të trojeve të zëna (që ndodhen brenda vijave kufizuese të qendrave të banuara) në komuna e bashki dhe tokës bujqësore e jobujqësore (që ndodhet jashtë vijave kufizuese të qendrave të banuara) të rrethit përkatës.

f) Komisioni publikon me mjetet e informacionit (televizion-emisioni i informacioneve të publikojë njoftimin për dy ditë rresht) për fillimin e realizimit të kompensimit me troje në zonë turistike, duke deklaruar afatin e pranimit të paraqitjes së dokumenteve të nevojshme për organizimin e llotarisë për një periudhë njëmuajore nga dita e shpalljes.

g) Personat e interesuar duhet të paraqesin pranë komisionit përkatës:

- Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve.

- Dokument zyrtar, ku të pasqyrohet vendndodhja e pronës, mbi bazën e të cilit ka operuar Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

h) Pas publikimit me mjetet e informacionit, Komisioni i Kompensimit Fizik afishon mjediset e tij:

- Studimin urbanistik të miratuar, në të cilin do të realizohet kompensimi fizik, dhe sasinë e sipërfaqes që ofrohet për kompensim e çmimin përkatës të zonës, në të cilën bëhet kompensimi. Në secilën parcelë njësi të studimit urbanistik të miratuar duhet të jetë i shënuar një numër, i cili emërton parcelën njësi.

- Brenda 15 ditëve pas mbylljes së afatit të pranimit të dokumenteve, Komisioni, pasi shqyrton dhe përpunon dokumentet e paraqitura, afishon listat emërore të kompensimit fizik me renditje të numrit rendor, sipas prioriteteve të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr.8084, datë 7.3.1996, dhe duhet të përmbajë:

- Numrin e parcelave njësi që përfitohen të përcaktuara si në pikën 4 të këtij vendimi (në të dyja mundësitë e përzgjedhjes, sipas rastit në zonë A ose në zonë B).

- Kompensimin në vlerë të sipërfaqes së mbetur.

Secili prioritet vlerësohet me një pikë. Gjithashtu, vlerësohen me një pikë edhe pretendimet për kompensim me më shumë se 5000 m<sup>2</sup> truall të konvertuar, por që për fazën e parë u lind e drejta të kompensohen me 5000 m<sup>2</sup>.

Pretenduesit që grumbullojnë pikë të barabarta grupohen në grupe, sipas të cilave do të përcaktohet edhe radha e tërheqjes së llotarisë.

i) Komisioni bën njoftimin publik me mjetet e informacionit (televizion-emisioni i informacioneve për dy ditë rresht) dhe cakton datën, orën dhe vendin e organizimit të llotarisë jo më pak se 30 ditë nga data e përfundimit të afatit 15-ditor të përshkruar më sipër në pikën “e” dhe jo më parë se 10 ditë nga dita e shpalljes. Data e publikuar e tërheqjes së llotarisë nuk zhvendoset.

k) Kryetari i Komisionit të Kompensimit Fizik është përgjegjës për organizimin e llotarisë. Ai duhet:

- Të sigurojë mjedisin e tërheqjes së llotarisë, duke u krijuar personave të interesuar një mjedis sa më të përshatshëm; të marrë masa që në tërheqjen e llotarisë të lejohen të marrin pjesë vetëm ish-pronarët (ose trashëgimtari i tij) ose përfaqësuesi i tij ligjor sipas listës së afishuar.

- Të marrë masat e pranisë së 2/3 të komisionit, si dhe të një noteri ditën e tërheqjes së llotarisë.

m) Ditën e tërheqjes së llotarisë ish-pronari (ose trashëgimtari i tij) apo përfaqësuesi ligjor paraqitet para komisionit dhe bën regjistrimin e prezencës në bazë të dokumentit identifikues, duke firmosur për pjesëmarrjen e tij. Në pamundësi të paraqitjes së vetë personit, personi pjesëmarrës në llotari duhet të paraqesë dokumentin e përfaqësimit nga ish-pronari apo trashëgimtari i tij me anë të një prokure të veçantë për këtë qëllim të noterizuar, e cila i dorëzohet komisionit.

Tërheqja të llotarisë të realizohet në praninë e noterit, i cili më parë ka kontrolluar vërtetësinë e dokumenteve të identitetit ose të prokurave të personave pjesëmarrës në llotari si dhe të procedurës.

n) Llotaria fillon me aq përfaqësues ligjorë sa janë të pranishëm. Hedhja e llotarisë do të fillojë duke hedhur në short me grupe, në bazë të renditjes së listës së shpallur, me grupet që kanë arritur pikët maksimale në vlerësimin e prioriteteve. Do të hidhet në short radha e përzgjedhjes së parcelave me pretendentët e një grupi. Në tërheqjen e llotarisë vendosen aq numra sa pretendentë janë, duke filluar nga numri një.

Ish-pronari (ose trashëgimtari i tij) ose përfaqësuesi i tij ligjor ka të drejtën e përzgjedhjes së pozicionit të parcelave njësi që jepen për kompensim (duke zgjedhur një nga dy mundësitë e përzgjedhjes, sipas rastit në zonë A ose në zonë B), duke publikuar numrin e parcelave të përzgjedhura prej tij (numri i parcelës është numri që parcela njësi mban në studimin urbanistik të miratuar). Çdo rezultat i shpallur hidhet në studimin urbanistik të miratuar me ngjyrë të dukshme. Gjithashtu, nga ana e komisionit mbahet protokoll i llogarisë dhe përbri emrit në listën emërore shënohen numrat tregues të parcelave, si dhe firma e ish-pronarit (ose trashëgimtarit të tij) ose përfaqësuesit të tij ligjor në dije të rezultatit të llotarisë.

Në përfundim të llotarisë, në prani të noterit dhe të pjesëtarëve të Komisionit të Kompensimit Fizik, prezent në tërheqjen e llotarisë, nënshkruhet një akt i noterizuar në tri kopje, ku të pasqyrohet rezultati i llotarisë. Njëra kopje të depozitohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive ose, në rast të mungesës së saj në hipotekë, një në arkivin e Komisionit të Kthimit Fizik dhe njëra do të jetë kopje pune.

Në mungesë të ish-pronarit (apo trashëgimtarit të tyre) ose përfaqësuesit të tij ligjor që nuk paraqitet ditën e tërheqjes së llotarisë, komisioni vendos për pozicionin e truallit të tij.

p) Çdo fitues i llotarisë pajiset me vendimin e komisionit, i cili shoqërohet edhe me gen-planin

përkatës të vendndodhjes së truallit (në bazë të aktit të mësipërm të noterizuar). Ky akt nënshkruhet nga kryetari i komisionit.

Kalimi në pronësi i sipërfaqes të fituar bëhet nëpërmjet vendimit të Komisionit, vendim i cili do të regjistrohet në hipotekë dhe në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme të rrethit përkatës. Vendimi shoqërohet me hartën treguese të vendndodhjes së truallit.

10. Për zbatimin në terren të vendimit të komisionit ngarkohet seksioni i urbanistikës dhe ai i kadastrës së rrethit mbi bazën e projektzbatimeve urbanistike dhe të infrastrukturës të miratuara.

11. Komisioni shtetëror i kompensimit fizik si dhe ai i rretheve do të operojnë me vulë të veçantë.

12. Fillimi i fazës së dytë caktohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**

TABELE E KOEFICIENTEVE PER KOMPENSIMIN E TRUALLIT TE QENDRAVE  
TE BANUARA, ME TRUALL NE ZONA TE ZHVILLIMIT TE TURIZMIT TE NIVELIT

**LLUKS, TE LARTE DHE TE MESEM**

Ne baze te Ligjit Nr. 7832 dt. 16/06/1994 me ndryshimet perkatese

|                        |          |      |             |                                                                                                              |                        |
|------------------------|----------|------|-------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|
|                        |          |      |             | Trualli i dhene ne kompensim brenda vijave kufizuese te qendrave te banuara dhe ne zonat me interes turistik |                        |
|                        |          |      |             | <b>Zone e zhvillimit te turizmit te nivelit lluks</b>                                                        |                        |
|                        |          |      |             | <b>A</b>                                                                                                     | <b>B</b>               |
|                        |          |      |             | cmimi<br>3200 L/m2                                                                                           | 3200x0.75<br>2400 L/m2 |
| Q.B.                   | mbi      | A    | 720 lek/m2  | 0.225                                                                                                        | 0.3                    |
| jashte                 | 20000 b. | B    | 480 lek/m2  | 0.15                                                                                                         | 0.2                    |
| zones                  | nen      | A    | 320 lek/m2  | 0.1                                                                                                          | 0.13                   |
| turistike              | 20000 b. | R.V. | 480 lek/m2  | 0.15                                                                                                         | 0.2                    |
| Qendra te banuara      |          | A    | 3200 lek/m2 | 1                                                                                                            | 1.33                   |
| brenda zones turistike |          | B    | 2400 lek/m2 | 0.75                                                                                                         | 1                      |
|                        |          |      |             | <b>Zone e zhvillimit te turizmit te nivelit te larte</b>                                                     |                        |
|                        |          |      |             | <b>A</b>                                                                                                     | <b>B</b>               |
|                        |          |      |             | cmimi<br>1600 L/m2                                                                                           | 1600x0.75<br>1200 L/m2 |
| Q.B.                   | mbi      | A    | 720 lek/m2  | 0.45                                                                                                         | 0.6                    |
| jashte                 | 20000 b. | B    | 480 lek/m2  | 0.3                                                                                                          | 0.4                    |
| zones                  | nen      | A    | 320 lek/m2  | 0.2                                                                                                          | 0.26                   |
| turistike              | 20000 b. | R.V. | 480 lek/m2  | 0.3                                                                                                          | 0.4                    |
| Qendra te banuara      |          | A    | 1600 lek/m2 | 1                                                                                                            | 1.33                   |
| brenda zones turistike |          | B    | 1200 lek/m2 | 0.75                                                                                                         | 1                      |
|                        |          |      |             | <b>Zone e zhvillimit te turizmit te nivelit te mesem</b>                                                     |                        |
|                        |          |      |             | <b>A</b>                                                                                                     | <b>B</b>               |
|                        |          |      |             | cmimi<br>800 L/m2                                                                                            | 800x0.75<br>600 L/m2   |
| Q.B.                   | mbi      | A    | 720 lek/m2  | 0.9                                                                                                          | 1.2                    |
| jashte                 | 20000 b. | B    | 480 lek/m2  | 0.6                                                                                                          | 0.8                    |
| zones                  | nen      | A    | 320 lek/m2  | 0.4                                                                                                          | 0.53                   |
| turistike              | 20000 b. | R.V. | 480 lek/m2  | 0.6                                                                                                          | 0.8                    |
| Qendra te banuara      |          | A    | 800 lek/m2  | 1                                                                                                            | 1.33                   |
| brenda zones turistike |          | B    | 600 lek/m2  | 0.75                                                                                                         | 1                      |

**TABELE E KOEFICIENTEVE PER KOMPENSIMIN E TRUALLIT TE QENDRAVE**  
**TE BANUARA ME TRUALL NE ZONA TE ZHVILLIMIT TE TURIZMIT TE NIVELIT**  
**LLUKS, TE LARTE DHE TE MESEM**

Ne baze te Ligjit Nr. 7832 dt. 16/06/1994 me ndryshimet perkatese

|                        |          |      |             |                                                                                                              |           |
|------------------------|----------|------|-------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
|                        |          |      |             | Trualli i dhene ne kompensim brenda vijave kufizuese te qendrave te banuara dhe ne zonat me interes turistik |           |
|                        |          |      |             | Zone e zhvillimit te turizmit te nivelit lluks                                                               |           |
|                        |          |      |             | A                                                                                                            | B         |
|                        |          |      |             | cmimi                                                                                                        | 3200x0.75 |
|                        |          |      |             | 3200 L/m2                                                                                                    | 2400 L/m2 |
| Q.B.                   | mbi      | A    | 720 lek/m2  | 0.225                                                                                                        | 0.3       |
| jashte                 | 20000 b. | B    | 480 lek/m2  | 0.15                                                                                                         | 0.2       |
| zones                  | nen      | A    | 320 lek/m2  | 0.1                                                                                                          | 0.13      |
| turistike              | 20000 b. | R.V. | 480 lek/m2  | 0.15                                                                                                         | 0.2       |
| Qendra te banuara      |          | A    | 3200 lek/m2 | 1                                                                                                            | 1.33      |
| brenda zones turistike |          | B    | 2400 lek/m2 | 0.75                                                                                                         | 1         |
|                        |          |      |             | Zone e zhvillimit te turizmit te nivelit te larte                                                            |           |
|                        |          |      |             | A                                                                                                            | B         |
|                        |          |      |             | cmimi                                                                                                        | 1600x0.75 |
|                        |          |      |             | 1600 L/m2                                                                                                    | 1200 L/m2 |
| Q.B.                   | mbi      | A    | 720 lek/m2  | 0.45                                                                                                         | 0.6       |
| jashte                 | 20000 b. | B    | 480 lek/m2  | 0.3                                                                                                          | 0.4       |
| zones                  | nen      | A    | 320 lek/m2  | 0.2                                                                                                          | 0.26      |
| turistike              | 20000 b. | R.V. | 480 lek/m2  | 0.3                                                                                                          | 0.4       |
| Qendra te banuara      |          | A    | 1600 lek/m2 | 1                                                                                                            | 1.33      |
| brenda zones turistike |          | B    | 1200 lek/m2 | 0.75                                                                                                         | 1         |
|                        |          |      |             | Zone e zhvillimit te turizmit te nivelit te mesem                                                            |           |
|                        |          |      |             | A                                                                                                            | B         |
|                        |          |      |             | cmimi                                                                                                        | 800x0.75  |
|                        |          |      |             | 800 L/m2                                                                                                     | 600 L/m2  |
| Q.B.                   | mbi      | A    | 720 lek/m2  | 0.9                                                                                                          | 1.2       |
| jashte                 | 20000 b. | B    | 480 lek/m2  | 0.6                                                                                                          | 0.8       |
| zones                  | nen      | A    | 320 lek/m2  | 0.4                                                                                                          | 0.53      |
| turistike              | 20000 b. | R.V. | 480 lek/m2  | 0.6                                                                                                          | 0.8       |
| Qendra te banuara      |          | A    | 800 lek/m2  | 1                                                                                                            | 1.33      |
| brenda zones turistike |          | B    | 600 lek/m2  | 0.75                                                                                                         | 1         |

**TABELE E KOEFICIENTEVE PER KOMPENSIMIN E TRUALLIT TE QYTETIT TE  
TIRANES ME TRUALL NE ZONA TE ZHVILLIMIT TE TURIZMIT TE NIVELIT**

**LLUKS, TE LARTE, DHE TE MESEM**

Ne baze te Ligjit Nr. 7832 dt. 16/06/1994 me ndryshimet perkatese

( SIPERFAQE PER KOMPENSIM X KOEFICINTI = SIPERFAQE QE KOMPENSOHET )

|        |   |             |                                                                                                              |                            |
|--------|---|-------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|
|        |   |             | Trualli i dhene ne kompensim brenda vijave kufizuese te qendrave te banuara dhe ne zonat me interes turistik |                            |
|        |   |             | Zone e zhvillimit te turizmit te nivelit lluks                                                               |                            |
|        |   |             | A (e larte)                                                                                                  | B                          |
|        |   |             | Cmimi<br>3200 lek/m2                                                                                         | 3200x 0.75<br>2400 lek/m2  |
| TIRANA | A | 1600 lek/m2 | 0.5                                                                                                          | 0.666                      |
|        | B | 1200 lek/m2 | 0.375                                                                                                        | 0.5                        |
|        | C | 800 lek/m2  | 0.25                                                                                                         | 0.33                       |
|        |   |             | Zone e zhvillimit te turizmit te nivelit te larte                                                            |                            |
|        |   |             | A (e mesme)                                                                                                  | B                          |
|        |   |             | Cmimi<br>1600 lek/m2                                                                                         | 1600 x 0.75<br>1200 lek/m2 |
| TIRANA | A | 1600 lek/m2 | 1                                                                                                            | 1.33                       |
|        | B | 1200 lek/m2 | 0.75                                                                                                         | 1                          |
|        | C | 800 lek/m2  | 0.5                                                                                                          | 0.666                      |
|        |   |             | Zone e zhvillimit te turizmit te nivelit te mesem                                                            |                            |
|        |   |             | A (masive)                                                                                                   | B                          |
|        |   |             | Cmimi<br>800 lek/m2                                                                                          | (800 x 0.75)<br>600 lek/m2 |
| TIRANA | A | 1600 lek/m2 | 2                                                                                                            | 2.66                       |
|        | B | 1200 lek/m2 | 1.5                                                                                                          | 2                          |
|        | C | 800 lek/m2  | 1                                                                                                            | 1.33                       |